



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:213781  
Datë: 26.02.2025  
Numri i dokumentit: 06909255

**P.nr.103/24**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, Divizioni Penal**, me gjyqtaren e vetme gjykuese Blerta Kelmendi, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Leonita Lajçi Muçaj, në çështjen penale kundër të pandehurit L.M, nga Peja, për shkak të veprës penale “*Lëndim i lehtë trupor*” nga neni 185 par.2 e lidhur me par.1 pika 1.4 të KPRK-së, duke vepruar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë–Departamenti i Përgjithshëm, nën shenjë PP/II.nr.1735/23 të datës 19.10.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik, të mbajtur me datën 13.02.2025, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Argzon Hasi, nga Prokuroria Themelore në Pejë, të dëmtuarit N.M, të pandehurit L.M, si dhe mbrojtësit të tij av. Agron Kuçi, nga Gjakova, sipas autorizimit, me datën 18.02.2025, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datën 26.02.2025, përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I pandehuri:**

**L.M** , i lindur më datë ....., në ....., tani me banim në ....., Lagjja .... rr. ..., Banesat ....., hyrja ..., nr... , nga i ati M. dhe e ëma S., e lindur ....., ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, student, i gjendjes së dobët ekonomike, posedon numër tel. ...., i identifikuar sipas numrit personal ....., Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, **mbrohet në liri**.

**ËSHTË FAJTOR**

**Për shkak së:**

*Me datë 13.09.2023 rreth orës 07:06, në Junik, Rruga “.....”, saktësisht para dymës të shtëpisë të të dëmtuarit , i pandehuri me dashje i shkakton lëndime trupore, personit tjetër këtu të dëmtuarit N.M, në atë mënyrë që, për shkak të mosmarrëveshjeve mes tyre pasi i pandehuri se ditën kritike duke vozitur automjetin e tij me shpejtësi të madhe rrugës së lagjes e kishte goditur në dorë të dëmtuarin i cili ishte në rrugë, pasi i dëmtuari i kishte kërkuar që të vozit nga dal dhe të ketë kujdes, i pandehuri i revoltuar nga dera e automjetit i tij merr shtagën e bezbollit me të cilën e sulmon të dëmtuarin duke e goditur dy herë kokë, me ç‘rast i shkakton, lëndime*

*të lehta trupore lëndime të konstatuara dhe përshkruara hollësisht në ekspertizën mjeko-ligjore të ekspertit mjeko-ligjor të Dr.Birgita Curri, të dt.29.09.2023.*

-Me çka ka kryer veprën penale **“Lëndim i lehtë trupor”** nga neni 185 par.2 e lidhur me par.1 pika 1.4 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të dispozitave ligjore të nenit 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 43, 44, 69, 70, 79 dhe neni 185 par.2 e lidhur me par.1 pika 1.4 të KPRK-së, si dhe neni 364, 365, 449, 462, të njëjtin e:

## **G J Y K O N**

- I.** Me **DËNIM ME BURG** në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajsh, i cili dënim me pëlqimin e tij, e në kuptim të nenit 44 par. 1 dhe 2 të KPRK-së, i është **ZËVENDËSUAR** me **DËNIM ME GJOBË** në shumën prej dymijë (2000) euro, në të cilin dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në ndalim prej dyzetë e tetë (48) orësh, nga dt.13.09.2023 e deri me 15.09.2023, të cilin dënim i pandehuri obligohet të e paguajë brenda afatit prej nëntëdhjetë (90) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit.
- II.** Nëse i pandehuri, dështon, refuzon apo nuk dëshiron që ta paguajnë dënimin e shqiptuar me gjobë si në pikën I, të këtij aktgjykimi, i njëjti do të zëvendësohet në dënim me burgim duke i llogaritur shumën prej njëzetë (20) euro, për një ditë burgimi.
- III.** **OBLIGOHET**, i pandehuri që të paguajë shpenzimet e procedurës penale ashtu që për ekspertizën mjeko-ligjore të paguaj shumën prej njëzetë (20) euro, të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej tridhjetë (30) euro, si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit të paguajë shumën prej njëzetë (20) euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.
- IV.** Në bazë të nenit 276 par.1 e lidhur me par 2 nenpar.2.1 të KPRK-së, konfiskohet në mënyrë të përhershme mjete-një ....., ....., i sekuestruar në bazë të vendimit për sekuestrim me numër ..... Urdhërohet Policia e Kosovës, që pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit të bëjë shkatërrimin e tij sipas procedurave standarde ligjore në fuqi.
- V.** I dëmtuari N.M, nga Komuna e Junikut, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm me datën 19.10.2023, ka ngritur aktakuzën nën shenjen PP/II.nr.1735/23, kundër të pandehurit L.M, për shkak të veprës penale **“Lëndim i lehtë trupor”**, nga neni 185 par.2 të KPRK-së.

Gjykata në këtë çështje penale ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datën 13.02.2025, në të cilën kanë qenë prezentë Prokurori i Shtetit Argzon Hasi, nga Prokuroria Themelore në Pejë, i dëmtuari N.M, i pandehuri L.M si mbrojtësi i tij, av. Agron Kuçi nga Gjakova, sipas autorizimit.

Në këtë seancë, gjykata në pajtim me nenin 241 par.1 të KPPRK-së, e ka udhëzuar të pandehurin L.M, për të drejtën e tij për të mos u deklaruar në çështjen e tij ose të mos përgjigjet në pyetje dhe nëse ai deklaroi për çështjen, se nuk ka për detyrë të inkriminojë vetveten ose të afërmit e tij, as të pranojë fajësinë, të mbrohet vetë ose nëpërmjet ndihmës juridike nga mbrojtësi sipas zgjedhjes së tij, të kundërshtojë aktakuzën dhe provueshmërinë e provave të paraqitura në aktakuzë.

Prokurori i shtetit para leximit të aktakuzës ka deklaruar se: *gjatë përpilimit të aktakuzës është lëshuar një gabim teknik sa i përket kualifikimit të veprës penale, me ç'rast duhet të shtohet lidhur me par. 1 pika 1.4 të KPRK-së.* Tutje, pasi që gjykata është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën dhe nuk ka nevojë për sqarime shtesë, e ka njoftuar të pandehurin për pasojat dhe privilegjet e pranimit të fajësisë, dhe pasi që është bindur së i pandehuri e ka kuptuar përparësitë dhe pasojat e pranimit të fajësisë, të njëjtit i ka dhënë mundësinë që të deklarohet për fajësinë apo pafajësinë.

I pandehuri L.M, i ftuar që të deklarohet për fajësinë apo pafajësinë, ka deklaruar së e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës, respektivisht për veprën penale “*Lëndim i lehtë trupor*” nga neni 185 par.2 lidhur me par. 1 pika 1.4 të KPRK së.

Në vlerësimin e pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit L.M, gjykata ka kërkuar mendimin nga ana e Prokurorit të Shtetit Argzon Hasi, i cili ka deklaruar se: *pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.* Me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit të lartcekur është pajtuar i dëmtuari N.M, i cili ka deklaruar se: *pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.*

Lidhur me pranimin e fajësisë është pajtuar edhe mbrojtësi i të pandehurit L.M, av.Agron Kuçi deklaroi se: *pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit tim, është bërë në konsultim të mjaftueshëm me mua si mbrojtës pas sqarimit të pasojave dhe privilegjeve të pranimit të fajësisë.*

Gjyqtarja e vetme gjykuese duke vlerësuar pranimin e fajësisë së bërë nga ana e të pandehurit, në bazë të nenin 242 par. 2 nën par. 2.1 e deri 2.4 të KPPRK-së, vlerësoi dhe gjeti së i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, së këtë pranim të fajësisë e ka bërë në mënyrë vullnetare, pa presion, dhe pasi që i janë komunikuar të gjitha të drejtat sipas KPPRK-së, së një pranim i tillë i fajësisë ka mbështetje në faktet e çështjes si dhe në materialet e dorëzuara nga Prokuroria siç janë: *Raporti fillestar i Incidentit nr. 2023-DJ-019 dt. 13.09.2023 nga D.G CP 3268, Raporti Oficerit D.G KPS 3268 dt.13.09.2023, deklarata e të dëmtuarit N.M e dhënë në polici me dt.13.09..2023, deklarata e dëshmitarit A.M dhënë në Polici të dt. 13.09.2023 dhe*

*prokurori dt.09.10.2023, deklarata e te pandehurit L.M dhënë në Polici e dt. 13.09.2023 dhe Prokurori dt.09.10.2023, Raporti i Spitalit te Përgjithshëm ne I.G në Gjakovë për të të dt.13.09.2023, Raporti nga QKMF Junik për të dëmtuarin L.M dt.13.09.2023 Vërtetim mbi sekuestrimin e Përkohshëm të Sendeve nga O.S, KI 2443, Akt ekspertimi mjeko ligjor i te dëmtuarve N.M dhe L.Mt dt.29.09.2023, foto albumi i vendit te ngjarjes, dhe së aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, ashtu që në bazë të nenit 242 par.6 të KPPK-së, me aktvendim ka aprovuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri pasi që është bindur plotësisht se i pandehuri ishte i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë dhe se i pandehuri e ka pranuar fajësinë pa presion dhe me vullnetin e tij të plotë, duke vazhduar me shqiptimin e dënimit.*

*Pasi që palët njëzëri kanë deklaruar se nuk propozojnë që të caktohet seanca e posaçme për matjen e dënimit konform nenit 356 të KPPRK-së, pasi që nuk ka nevojë për një seancë të tillë, gjykata ka vazhduar seancën duke i ftuar palët që të deklarohen në fjalën e tyre lidhur me rrethanat për shqiptimin e dënimit.*

*Prokurori i Shtetit Argzon Hasi, ka deklaruar se: sa i përket rrethanave rënduese kërkojmë që të mirët parasysht mënyra e kryerjes së veprës penale ndërkaq si rrethanë lehtësuese të mirët pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit.*

*I dëmtuari N.M, ka deklaruar se: i pandehuri nuk më ka kërkuar falje, prej që ka ndodhur rasti i njëjti dhe as familjaret e tij nuk më kanë vizituar, ne jemi pajtuar kur ka qene prezent hoxha dhe kryetari i komunës se Junikut mirëpo i kam ra pishman që jemi pajtuar sepse e gjithë kjo çka ka ndodhur ka qenë pa fajin tim, i njëjti më ka nxjerr problem në shtëpinë time dy ditë para se ta martoj vajzën, i njëjti më ka rënë tinëz, dëshiroj që i njëjti të dënohet sipas ligjit, dëshiroj të parashtroj kërkesë pasurore juridike, nuk kam diçka tjetër të shtoj.*

*Mbrojtësi i të pandehurit L.M, av.Agron Kuçi, ka deklaruar se: e vlerësoi që pas pranimin të fajësisë nga i mbrojturi im dhe miratimit nga ana e gjykatës, gjykata duhet të marr parasysht te gjitha rrethanat lehtësuese me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit ashtu që e vë në dijeni gjykatën që nga rrethanat personale të mbrojturit L., i njëjti është student, jeton me dy motrat dhe nënën, gjithashtu edhe vet është student dhe kryefamiljar i cili mban familjen nga puna që bënë si kamerier, gjatë gjithë procedurave penale ka bashkëpunuar me organet e drejtësisë, është penduar thellë, ka kërkuar falje, është zotuar se nuk do të përsërisë ndonjë veprë të ngjashme dhe asnjëherë deri më tani nuk ka rënë ndesh me ligjin, andaj duke i përmbledhur të gjitha këto rrethana lehtësuese dhe duke mos ekzistuar rrethanat rënduese gjykata me rastin e caktimit të dënimit të aplikoj dispozitat për zbutjen e dënimit përkatësisht të shqiptoj një dënim nën minimumin ligjor, krejt në fund i propozoj gjykatës me rastin e caktimit dhe llojin e dënimit ti shqiptoj dënim të kushtëzuar me gjobë për shkak të pamundësisë financiare për arsye se është edhe familjar dhe i duhet të i ndihmoj familjes.*

*I pandehuri L.M, ka deklaruar se: jam penduar për veprën penale të cilën e kam kryer, i premtoj gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, të dëmtuarit nuk kam pasur*

*rast që ti kërkoj falje por që jam i gatshëm tani ti kërkoj, pajtohem në tërësi me deklarinimin e avokatit tim.*

Nga faktet e vërtetuara nga shkresat e lëndës, nga deklarinimet e palëve në procedurë dhe nga vet pranimi i fajësisë nga i pandehuri, gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit, ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, si dhe vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, prandaj gjykata edhe e shpalli fajtor të njëjtin pasi që më parë gjeti se penalisht është përgjegjës

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës. Sa i përket fajësisë i pandehuri është i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe gjykata e ka vërtetuar se e ka kryer me dashje.

Sa i përket vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata në kuptim të dispozitave ligjore të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, ka gjetur si rrethana lehtësuese për të pandehurin L.M, faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën e kryer penale, pendimin e shprehur nga ana e të njëjtit si dhe premtimin e tij që në të ardhmen nuk do të përsërisë veprën e tillë penale, moshën e tij i cili në kohën e kryerjes se veprës penale ishte .. vjeçar, kërkim faljen palës se dëmtuar te shprehur gjate shqyrtimit gjyqësor, faktin se i njëjtit nuk ka qenë i dënuar më parë, po ashtu gjykata pati parasysh edhe faktin se i njëjti është student dhe kryefamiljar i cili mban familjen nga puna qe bene si kamerier, ndërsa në rastin konkret si rrethana rënduese për të pandehurin gjykata vlerësoi shkallën e dashjes dhe përgjegjësisë penale, rrezikshmërinë konkrete të veprës penale të kryer nga i pandehuri. Duke u nisur nga të gjitha këto gjykata të pandehurit i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, të cilin dënime pëlqimin e të pandehurit si dhe konform nenit 43 dhe 44 të KPRK-së, i'a ka zëvendësuar me dënim me gjobë.

Gjykata në bazë të nenit 44 par. 1 dhe 2 të KPRK-së, ku përcaktohet se: *“Kur gjykata shqipton dënimin me burgim deri në gjashtë (6) muaj, gjykata njëkohësisht mund të vendosë që dënimi me burgim të zëvendësohet me dënim me gjobë, me pëlqimin e personit të dënuar”*, me pëlqimin e të pandehurit dënimin me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, ia zëvendësoi në dënim me gjobë në shumë prej dymijë (2000) euro, e kjo sipas pëlqimit të cilin e ka dhënë i pandehuri e poashtu edhe mbrojtësi i tij me autorizim av.Agron Kuçi, shprehimisht në procesverbalin e shqiptimit të dënimit të datës 18.02.2025.

Në rastin konkret gjykata vlerëson se dënimi i shqiptuar me burg efektiv e pastaj i zëvendësuar në dënim me gjobë me pëlqimin e të pandehurit, ndaj të njëjtit, është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit sipas nenit 69 par.3 të KPRK-së, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e kryesit, si dhe do të ndikoj tek të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit sipas nenit 38 të KPRK-së.

Me rastin e shqiptimit të dënimit me gjobë, gjykata përveç rrethanave të cekura, ka vlerësuar dhe ka marrë parasysh edhe kushtet dhe mundësitë materiale për pagimin e gjobës, duke vlerësuar se dënimi me gjobë i shqiptuar për të pandehurin është i përballueshëm për kushtet ekonomike të tij.

Vendimi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi për llogaritjen e ndalimit të të pandehurve për dyzetetë (48) orë në dënimin e shqiptuar me gjobë, gjykata e mori duke u bazuar në nenin 79 par.4 të KPRK-së, i cili shprehimisht parasheh se: *“Një (1) ditë paraburgim, një (1) ditë heqje lirie, një (1) ditë burgim dhe njëzetë (20) euro të dënimit me gjobë barazohen për qëllime të llogaritjes sipas këtij neni”*, me çrast shumës së dënimit me gjobë prej 2000 euro, duke i llogariten shuma prej dyzetë (40) euro, sa i pandehuri ka qenë në ndalim, me çrast i njëjti obligohet që të paguajë shumën e mbetura prej një mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë (1960) euro,

Vendimi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, për zëvendësimin eventual e dënimit të shqiptuar me gjobë me dënim burgimi në rast se i pandehuri dështon apo refuzon ta paguajë dënimin me gjobë u morr konform nenit 43 par. 3 dhe 4 të KPRK-së.

Vendimin lidhur me konfiskimin, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjykata e mori konform nenit 276 par.1 të KPPRK-së, ku përcaktohet se: *“Pasuria që është qenësisht e rrezikshme ose e paligjshme i nënshtrohet konfiskimit, në cilëndo fazë të procedurës nga gjyqtari kompetent, pa marrë parasysh fajësinë apo pafajësinë e të pandehurit dhe pavarësisht nëse prokurori i shtetit e ka ndërmarrë apo jo ndonjë veprim për ta konfiskuar pasurinë”*, me çrast është konfiskuar mjetei-një ....., ....., i sekuestruar në bazë të vendimit për sekuestrim me numër ....., të datës ..... dhe është urdhëruar Policia e Kosovës, që pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit të bëjë shkatërrimin e tij sipas procedurave standarde ligjore në fuqi.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale, ekspertizën mjeko-ligjore si dhe të paushallit gjyqësor, u morr në bazë të nenit 449 par.1 dhe 2, nënpar.2.1 dhe nën par. 2.6, të KPPRK-së, ndërsa konform nenit 36 par.1, 2, 3, nën par. 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, gjykata të pandehurin e obligoi në pagesën e taksës për kompensimin e viktimave të krimit, si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Vendimi si në pikën IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi që i dëmtuari N.M, nga Komuna e Junikut, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt civil, u mor konform në kuptim të nenit 462 par.1 dhe 2 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në kuptim të nenit 364 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL**  
**P.nr.103/24, me datën 26.02.2025.**

**Bashkëpunëtorja profesionale:**

**Gjyqtarja e vetme gjyquese:**

---

**Leonita Lajçi Muçaj**

---

**Blerta KERMENDI**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda tridhjetë (30) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.